

**NDËRLIDHJA MIDIS VIKTIMIZIMIT DHE REZILIENCËS TEK
NXËNËSIT E SHKOLLAVE TË MESME TË ULËTA**

**TEMA PËR TITULLIN
MASTER I ARTEVE NË DEPARTAMENTIN E PSIKOLOGJISË**

MENTORE: KALTRINA KELMENDI

NGA

ZAMBAKE GASHI



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I PSIKOLOGJISË, PSIKOLOGJI KLINIKE DHE
SHËNDETI**

PRISHTINË

SHKURT, 2023

Ndërlidhja midis viktimizimit dhe reziliencës tek nxënësit e shkollave të mesme të ulëta në kontekstin e shoqërisë kosovare është tema e këtij studimi. Ky studim përfshinë mjediset ku ushtrohet dhuna duke tentuar që të jap të dhëna mbi nivelin i dhunës, format dhe llojet e dhunës që ushtrohen ndaj fëmijëve, moshën e fëmijëve kur ushtrohet më shumë dhe personat që ushtrojnë më shpesh dhunë ndaj fëmijëve si dhe modelin e reziliencës. Para se gjithash, fokusi kryesor i studimit tonë është ndërlidhja në mes të viktimizimit dhe reziliencës që kanë nxënësit në rastet kur përjetojnë dhunë. Gjithashtu, studimi përfshinë edhe ekspozimin e fëmijës ndaj dhunës, që përfshin rastet kur ata ekspozohen ndaj dhunës në familje, ose edhe në dhunën që ushtrohet ndaj moshatarëve të tyre.

Koncepti i reziliencës në ditët e sotme po hulumtohet si një mënyrë për të punuar me fëmijët që kishin pësuar përvoja traumatike, në mënyrë që të "shërohen" nga dhuna apo ngjarjet abuzive që ata kanë përjetuar dhe të kenë një jetë "normale". Është përcaktuar nga disa autorë në shumë mënyra të ndryshme si reziliencia krijohet nga në raste të përjetimeve të tilla. Mënyra se si përcaktohet reziliencia me kalimin e kohës ndoshta ndikon në mënyrën se si matet dhe si ndërhyhet me të.

Autorët Conëay dhe McDonough (2006) përkufizuan reziliencën emocionale si “aftësia për të gjeneruar emocione pozitive dhe për t’u rikuperuar shpejt nga përvojat negative emocionale” (f. 272). Sipas Henry (1999) reziliencia “i atribuohet fëmijëve që janë rritur në rrethana të pafavorshme pa treguar pasoja të pafavorshme” (f. 521), Reziliencia është “aftësia për adaptim të suksesshëm, funksionim pozitiv ose kompetencë pavarësisht rrezikut të lartë, stresit kronik ose traumave të rënda” (f. 521). Autorë të tjerë si Roy et al. (2011) përkufizojnë reziliencën si aftësinë për të lulëzuar përballë fatkeqësive ose për tu rikuperuar nga ngjarjet negative. Prandaj, mund të vërehet se çdo autori ka mënyrën e tij / saj të përcaktimit të konceptit të reziliencës dhe si pasojë, mënyrën e tij / saj personale të operacionalizimit të tij në matje dhe ndërhyrje. Përvojat e hershme të fëmijëve besohet të jenë përbërës të rëndësishëm të reziliencës. Hulumtuesit në fushën e reziliencës (Southëick, Bonanno, Masten, Panter-Brick, & Yehuda, 2014) pajtohen se, "Jeta e fëmijëve është ngulitur në familje dhe në shkollat si dhe në komunitete e kultura" (f. 7). Studimet kërkimore janë përqendruar në natyrën shumëdimensionale të

reziliencës, duke marrë parasysh faktorët e rrezikut dhe faktorët mbrojtës që kontribuojnë në shërimin e traumave dhe rezultateve negative (Luthar, Cicchetti, & Becker, 2000).

Ky studim kontribuon në fushën e zhvillimit të fëmijëve dhe edukimit të hershëm duke u përqëndruar në të dhëna përshkruese në lidhje me reziliencën dhe përjetimin e dhunës që kanë krijuar apo posedojnë fëmijët e moshës 12-15 vjeç. Duke marrë për bazë që ky studim është korrelacional dhe studion ndërlidhjen në mes të kopecepteve dhe variablave atëher informacionet që mund të na ofroj mund të jenë të dobishme në hartimin e shërbimeve për familjet që do të mbështesnin ruajtjen e reziliencës dhe zhvillimin e reziliencës tek fëmijët e vegjël që jetojnë në mjedise me rrezik të lartë.

Rezultatet e këtij studimi treguan se ekziston një ndërlidhje pozitive në mes të reziliencës dhe përjetimit të dhunës tek fëmijët e moshës 12-15 vjeç, hipotezë kjo e analizuar përmes analizës së korealcionit të Pearsonit dhe ka rezultuar vijon [$r = .209^*$, $p = 0.03$]. Në një studim të bërë nga (Klomek et al., 2009; Ttofi, Farrington, Lösel, & Loeber, 2011; Winsper, Lereya, Zanarini, & Eölke, 2012), vertetoi rezultate pozitive pas përvojave të viktimizimit të ngacmimit në adoleshencën e hershme. Duke përdorur dhëna prospektive nga një grup i madh adoleshentësh ata gjetëm të dhëna të ngjashme me studimet e tjera se viktimizimi i shpeshtë i ngacmimit është zakonisht i lidhur me nivele më të larta të reziliencës. Megjithatë, megjithëse përjetuan ngacmime të shpeshta, disa adoleshentë ishin të tillë rezilient në atë që ata treguan më pak se sa pritej nivele të depresionit dhe delikuencës me kalimin e kohës.

Po ashtu ky studim tregoi se ekziston një ndërlidhje në mes të reziliencës dhe ngacmimit, hipotezë kjo e analizuar përmes analizës së korealcionit të Pearsonit dhe ka rezultuar si vijon [$r = -.328^*$, $p = 0.00$]. Sipas një studimi të bërë mbi ngacmimin nga (Barker et al., 2008) adoleshentët që kanë raportuar më pak viktimizim dhe ngacmim prireshin të ishin femra ato kishin vetëbesim më të lartë, po përjetonin nivele të ulëta konflikti me prindërit, nuk ishin viktimizuar nga vëllezërit e motrat dhe kishin më pak miq të ngushtë në krahasim me ata që raportuan më shumë ngacmim dhe viktimizim në të kalurën apo fëmijërine e tyre. Për sa i përket karakteristikave individuale dhe dallimeve gjinore parashikonin përshtatje pozitive tek adoleshentët e ngacmuar femra dhe ishin më reziliente se sa pjesëmarrësit meshkuj që kishin përjetuar ngacmim dhe viktimizim në të kaluarën këta ishin më pak resiliencë dhe kishin gjasa të raportonin nivele më të

ulëta larta se sa pritej të depresionit pas bullizmit. Nga ana tjetër, femrat kishin më shumë gjasa raportojnë nivele më të ulëta se sa pritej të delikuencës pas bullizmit.

Po ashtu ky studim dha rezultate edhe mbi dallimet gjinore në përjetimin e dhunës dhe në reziliencë tek fëmijët e moshës 12-15 vjeç, hipotezë kjo e cila është analizuar përmes analizës së t-testit dhe ka rezultuar se kemi dallime gjinore në përjetimin e dhunës dhe reziliencë ku femrat kanë predispozita më të larta për resilience ndërsa meshkujt kanë predispozita më të larta për dhunë. Analiza e t-testit ka rezultuar në këtë vlerë për meshkuj $M= 85.15$ dhe $DS= 5.88$ ndërsa vlera për femra $M= 89.79$ dhe $DS= 11.99$.

Dallime gjinore në përjetimin e dhunës dhe në reziliencë u dëshmuar edhe përmes një studimi të bërë nga (Sullivan, Farrell, & Kliwer, 2006), ata konstatuan se ekzistonin dallime gjinore në përjetimin e dhunës apo edhe në prevalence për shfaqje të sjelljeve delikente më vonë pas përvojave të bullizmi. Disa studime kanë zbuluar se djemtë e ngacmuar kanë më shumë gjasa të përfshihen në sjellje delikente krahasuar me vajzat e ngacmuara (Sullivan, Farrell, & Kliwer, 2006) ndërsa të tjerët kanë gjetur se djemtë që kanë përjetuar dhunë kanë gjasë për të pasur nivele më të ulëta të reziliencës se sa vajzat e ngacmuara (Barker et al., 2008; Cullen, Unnever, Hartman, Turner, & Agnew, 2008).

Po ashtu gjatë këtij studimi të gjeturat tregojnë se ekziston një ndërlidhje në mes të fëmijëve që posedojnë status më të lartë ekonomik dhe të qenit më rezilient ndaj dhunës dhe ngacmimeve, hipotezë kjo e analizuar përmes analizës së korealacionit të Pearsonit dhe ka rezultuar si vijon [$r= .348^{**}$, $p= 0.00$]. Duke marrë parasysh rezultatet e dala nga ky studim ne duhet të dimë se adoleshenca është një periudhë mjaftë kritike dhe e ndjeshme, pasi që gjatë jetës së tyre ata përballen me situata të ndryshme dhe të vështira si në rrethin social, ashtu edhe në atë familjarë. Duke parë sfidat e adoleshentëve, atëherë shohim se viktimizimi është një ndër sfidat më të mëdha me të cilën përballen adoleshentët, prandaj përmes këtij studimi, kemi arritur që të shohim viktimizimin ndaj dhunës, reziliencën e tyre për ti tejkaluar këto sfida.